

Nr. Prot 156
01.01.2021



Albanian-American
Development Foundation



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ndërmjet

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë

dhe

Albanian-American Development Foundation

Për

Zbatimin e Programit të Liderimit "LEAD Albania"

21 Janar 2021

Ky Memorandum Mirëkuptimi (“**Memorandumi**”) lidhet nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë (këtu më poshtë referuar si “**ILD**”)

dhe

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (Albanian-American Development Foundation), një organizatë jofitimprurëse, e organizuar dhe themeluar sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, me seli në 14 East, 60th Street, Suite 407, New York, NY 10022, SH.B.A., që vepron me anë të degës së saj në Shqipëri, të regjistruar me Vendimin nr. 359, datë 18.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me zyrë të regjistruar në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, Ndërtesa 42, Hyrja 7, Apartamenti 60, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar rregullisht nga Z. Martin Mata dhe Z. Aleksandër Sarapuli, Drejtorë Ekzekutivë të Përbashkët (këtu më poshtë referuar si “**AADF**”)

Palët e mësipërme do të referohen në vijim individualisht si “**Pala**” dhe bashkërisht si “**Palët**”;

MEQENËSE:

- (A) AADF ka konceptuar Programin e Liderimit në Shqipëri “**LEAD Albania**” (referuar më poshtë si “**Programi**”), sipas modelit të Programit të Shtëpisë së Bardhë për Liderimin (*White House Fellows Program*) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllimin për t’u siguruar profesionistëve të rinj dhe të talentuar shqiptarë përvoja të drejtpërdrejta në procesin e qeverisjes së Shqipërisë;
- (B) Në vijim të zbatimit të suksesshëm të Programit në disa prej institucioneve shtetërore gjatë periudhës 2012-2018, sipas të gjithë treguesve të performancës, Bordi i Drejtorëve të AADF miratoi mbështetjen teknike administrative dhe financiare për vijimin e këtij Programi për një periudhë të dytë 5-vjeçare (2019-2024);
- (C) ILD e konsideron investimin për “Zhvillimin e Liderimit” thelbësor për zhvillimin afat-gjatë dhe të qëndrueshëm të vendit, nëpërmjet drejtuesve që kanë një njohje të thellë të sfidave dhe të punës së mirëqeverisjes dhe administratës, njohje e fituar nga përvoja direkte në nivelet drejtuese të institucioneve qeverisëse të vendit;
- (D) Në mbështetje të reformës në drejtësi dhe rritjes së kapaciteteve të Organeve të reja Qeverisëse të Sistemit të Drejtësisë, Palët kanë shprehur vullnetin për të bashkëpunuar me qëllim zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Programit.

PËR SA MË SIPËR, ILD dhe AADF bien dakord për të formalizuar marrëdhënien e tyre bashkërenduese dhe bashkëpunuese me qëllim zbatimin e Programit , si më poshtë vijon:

1. QËLLIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është angazhimi i Palëve për një marrëdhënie bashkërenduese dhe bashkëpunuese me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e Programit, sipas përshkrimit në Shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Memorandumi, si dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisë të Palëve për garantimin e mbarëvajtjes së Programit.

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR I AKTIVITETEVE TË PROGRAMIT

2.1. Aktivitetet e Programit të rëna dakord midis Palëve përmblihen si më poshtë:

- i. Përgatitja dhe ndjekja e proceseve të punës, udhëzuesve dhe procedurave që nevojiten për administrimin e Programit që nga thirrja për aplikime, përzgjedhja e kandidatëve, ndjekja e ecurisë së pjesëmarrësve deri në përfundim të Programit, përfshirë lëshimin e certifikatës për përfundimin me sukses të Programit.
- ii. Identifikimi dhe koordinimi me institucionet pritëse, ku do të caktohen dhe kryejnë punën pjesëmarrësit gjatë kohëzgjatjes një-vjeçare të Programit.
- iii. Administrimi dhe monitorimi i Programit dhe pjesëmarrësve gjatë gjithë vitit.
- iv. Përgatitja dhe realizimi i veprimtarive edukuese dhe trajnuese për pjesëmarrësit.
- v. Monitorimi dhe mbajtja e marrëdhënieve të vazhdueshme me ish-pjesëmarrësit e Programit në vite.

2.2. Një përshkrim më i hollësishëm i elementëve përbërës dhe aktiviteteve të Programit gjendet në Shtojcën 1 bashkëlidhur këtij Memorandumi.

3. PËRGJEGJËSITË E PALËVE

3.1. AADF do të:

- 3.1.1. Angazhojë fondet e nevojshme të parashikuara për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të Programit përgjatë kohëzgjatjes së këtij Memorandumi.
- 3.1.2. Administrojë Programin në bashkëpunim me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe palë të tjera të interesuara, në rastin e Pjesëmarrësve që shprehin interesin të angazhohen në punë pranë ILD-së në kuadër të Programit.
- 3.1.3. Zhvillojë një seri procedurash operacionale të qarta, të cilat do të udhëheqin dhe sigurojnë transparencë në zbatimin e Programit.
- 3.1.4. Marrë përsipër kryerjen e procedurave të thirrjes për aplikime, mbledhjes së aplikimeve dhe përzgjedhjes së kandidatëve për pjesëmarrje në Program.
- 3.1.5. Krijojë një komision përzgjedhjeje, i cili do të rishikojë dhe rekomandojë kandidatët finalistë për Pjesëmarrje në Program.
- 3.1.6. Bashkëpunojë dhe koordinojë punën me personin e kontaktit të caktuar nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të lehtësuar caktimin dhe fillimin e punës së pjesëmarrësit të Programit pranë kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- 3.1.7. Bashkëpunojë me ILD-në, për të përgatitur në mënyrë të detajuar përshkrimin e punës, veprimtaritë dhe detyrat.
- 3.1.8. Përbushë të gjitha detyrimet ligjore dhe financiare në cilësinë e punëdhënësit të Pjesëmarrësve gjatë kohëzgjatjes 1-vjeçare të Programit;
- 3.1.9. Pajisë pjesëmarrësit me mjetet dhe pajisjet e punës të nevojshme për përbushjen e detyrave të pjesëmarrësit sipas përshkrimit të punës;
- 3.1.10. Monitorojë ecurinë e Pjesëmarrësve gjatë Programit, si dhe në marrëdhëniet e tyre me ILD-në, me qëllimin për të siguruar mbarëvajtjen e Programit në lidhje me përbushjen e objektivave të tij për zhvillimin e lidershit në Shqipëri.
- 3.1.11. Krijojë dhe menaxhojë një numër lidhjesh e rrjetesh edukative, në mënyrë që Pjesëmarrësit të ndër marrin veprimtari përtej detyrave të pozicionit të tyre të punës.
- 3.1.12. Monitorojë ecurinë profesionale të ish-pjesëmarrësve të Programit në vite dhe do të nxisë dhe mbështesë kryerjen e aktiviteteve të inicuar prej tyre.

3.2. ILD do të:

- 3.2.1. Caktojë një person kontakti nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për bashkërendimin e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi me menaxherin e projektit të AADF, për koordinimin dhe sigurimin e mbarëvajtjes së Programit;

- 3.2.2. Marrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e afateve kohore për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve dhe të fillimit të punës pranë kabinetit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 3.2.3. Sigurojë një marrëdhënie bashkëpunuese dhe të favorshme për mbarëvajtjen e zbatimit e Programit;
- 3.2.4. Nënshkruajë një marrëveshje tre-palëshe me AADF dhe secilin Pjesëmarrës, për rregullimin e marrëdhënies së vënies në dispozicion të Pjesëmarrësit, nga AADF tek ILD;
- 3.2.5. Autorizojë, instrukttojë dhe drejtojë strukturat përkatëse në institucionin e tij për të mbështetur zhvillimin, vendosjen dhe veprimtaritë e Pjesëmarrësve gjatë Programit;
- 3.2.6. Sigurojë që Pjesëmarrësit të caktohen në pozicionin e Këshilltarit në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- 3.2.7. Sigurojë që Pjesëmarrësve t'u jepet akses në detyra dhe në përvoja sipas përshkrimit të detyrave dhe punës për pozicionin e Këshilltarit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pa dallim nga anëtarët e tjerë të Kabinetit, si dhe në përputhje me profesionin dhe eksperiencën profesionale të Pjesëmarrësit.

4. HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

- 4.1. Ky Memorandum hyn në fuqi me nënshkrimin e tij prej Palëve dhe është i vlefshëm për një kohëzgjatje të pacaktuar, deri në zgjidhjen e tij sipas Nenit 4.2 më poshtë.
- 4.2. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të zgjidhet në çdo kohë me marrëveshje reciproke midis Palëve ose në mënyrë të njëanshme nga secila Palë, me njoftim paraprak me shkrim prej të paktën 6 muajsh dërguar Palës tjetër.
- 4.3. Përfundimi i këtij Memorandumi do të ndikojë bashkëpunimin vetëm për procesin e përzgjedhjes të hapur pas datës efektive të zgjidhjes. Për qëllim qartësie, "hapje e procesit të përzgjedhjes" do të quhet data e publikimit të thirrjes për aplikime nga AADF. Angazhimet e Palëve sipas këtij Memorandumi për kandidatët ose pjesëmarrësit në proces dhe marrëveshjet në lidhje me to do të mbeten në fuqi deri në përfundimin e Programit (1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes tre-palëshe ndërmjet AADF, ILD-së dhe pjesëmarrësit), për secilin kandidat apo pjesëmarrës, ose deri në atë moment, në të cilin është gjetur një mirëkuptim midis Palëve për të ndërprerë Programin. Në këtë rast, Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi të tyre përkatëse ose reciproke, deri në përfundim të Programit për kandidatët ose Pjesëmarrësit në proces.

5. TË PËRGJITHSHME

- 5.1. Ky Memorandum përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve në lidhje me angazhimet e tyre të parashikuara këtu.
- 5.2. Çdo marrëveshje, kontratë apo protokoll tjetër ndërmjet Palëve, lidhur me projekte individuale të Programit apo për zbatimin e angazhimeve të Palëve sipas këtij Memorandumi, do të konsiderohen si pjesë përbërëse dhe do t'i nënshtrohen këtij Memorandumi.
- 5.3. Ky Memorandum nuk mund të ndryshohet përveçse me marrëveshje me shkrim dhe të nënshkruar nga të dyja Palët.
- 5.4. Mbështetja e siguruar nga AADF në lidhje me Programin është e kushtëzuar nga zbatimi i detyrave përkatëse të Palëve sipas këtij Memorandumi dhe bazohet në bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet Palëve.
- 5.5. Çdo mosmarrëveshje midis Palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet diskutimeve në mirëbesim mes Palëve.

NË PRANI TË NJËRA-TJETRËS, Palët, nëpërmjet personave të autorizuar rregullisht prej tyre, nënshkruajnë këtë Memorandum në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Z. Artur Metani
Inspektor


Datë: 21.01.2021



FONDACIONI SHQIPTARO-AMERIKAN PËR ZHVILLIM



Z. Martin Mata
Drejtor Ekzekutiv



Z. Aleksandër Sarapuli
Drejtor Ekzekutiv

Datë: 21.01.2021

SHTOJCA 1

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT “LEAD ALBANIA”

I. Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) u krijua në vitin 2009 nga Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (AAEF) me mbështetjen dhe inkurajimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. AADF është organizatë jofitimprurëse, vepron tërësisht në Shqipëri dhe qeveriset nga një Bord Drejtues. Misioni i Fondacionit është të ndihmojë për zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme të sektorit privat dhe të një shoqërie demokratike në Shqipëri dhe të kontribuojë në stabilitetin e Evropës Juglindore. AADF mbështet disa programe për të çuar përpara misionin e vet: arsim për zhvillim të qëndrueshëm, sipërmarrjen, zhvillimin e lidershit dhe mbështetjen e turizmit kulturor dhe eko-turizmit.

II. Programi “LEAD Albania”

AADF po zbaton që nga viti 2013, programin për zhvillimin e lidershit nën emrin “LEAD Albania” (Leadership Experience And Development). Programi është konceptuar bazuar në Programin e Shtëpisë së Bardhë për LiderShipin (angl. White House Fellows Program) në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qëllimi i Programit në Shqipëri është që t’u sigurojë profesionistëve të rinj dhe të talentuar shqiptarë përvoja të drejtpërdrejta në procesin e qeverisjes së Shqipërisë, shoqëruar nga një ndjesi e përfshirjes personale në liderShipin e shoqërisë nëpërmjet një përvoje njëvjeçare, që e vendos përfituesin në pozicionin e këshilltarit në kabinetet e Kryeministrit, Ministrave, Presidentit dhe Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Organeve Qeverisëse të Sistemit të Drejtësisë. Vendosja në institucione bëhet sipas interesit individual dhe përshtatshmërisë profesionale. Numri i të përzgjedhurve për pjesëmarrje në Program do të mbahet rreth dhjetë çdo vit. Angazhimi në punë në pozicionet e këshilltarëve të drejtuesve të institucioneve të sipërpërmendura është pjesa thelbësore e Programit. Detyrat e tyre kërkojnë përkushtim ndaj vendit të punës dhe gatishmëri e kapacitet për të mësuar shpejt. Pjesëmarrja në program kërkon angazhim me kohë të plotë për një vit.

Aktualisht, janë 78 individë që janë bërë pjesë e Programit. Prej 70 ish-pjesëmarrësve (Alumni) në Program, 100% janë të punësuar dhe rreth 70% e tyre janë të punësuar në pozicione të kategorizuara si pozicione drejtuese (pozicioni drejtues përcaktohet gjerësisht duke përdorur variabla të matshëm, si menaxhimi i drejtpërdrejtë i stafit dhe kategoritë e pagave). Rreth 30% e pjesëmarrësve të kategorizuar në pozicione jo-drejtuuese, janë të angazhuar si konsulentë privatë, pedagogë etj.

Vijimi i angazhimit/punësimit të pjesëmarrësve të Programit në qeverinë shqiptare për një kohë të gjatë pas perfundimit të Programit, konsiderohet të jetë i lartë. Ky konkluzion bazohet në analizën e të dhënave që kanë të bëjnë me ofertat e punësimit në sektorin publik. Mesatarisht 70% e pjesëmarrësve në Program vijnë nga sektori jo-publik, 45% e tyre vijojnë të zhvillojnë karrierën e tyre dhe të jenë të punësuar në sektorin publik.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, pesë vite më vonë nga zbatimi i tij, Programi LEAD Albania konsiderohet si një kontribues unik dhe prestigjioz në zhvillimin e lidershit të ardhshëm në Shqipëri. Mbi këto baza, AADF ka miratuar zgjatjen e Programit LEAD Albania në një periudhë të dytë pesëvjeçare, 2019 - 2024.

III. Angazhimi në punë

Angazhimi në punë në pozicione të larta në institucionet shtetërore është pjesa thelbësore e Programit. Individët e përzgjedhur do të punësohen për një vit si këshilltarë të zytarëve të lartë të Kryeministrit, të Ministrave të ndryshme, Institucionit të Presidentit, dhe Bashkisë Tiranë. Detyrat e tyre kërkojnë angazhim ndaj vendit të punës, kapacitet për të mësuar shpejt dhe gatishmëri për të punuar fort. Përgjegjësitë e individëve të përzgjedhur mund të jenë të spektri të gjerë. Individëve mund t’u kërkojë gjithashtu të

punojnë edhe për çështje jashtë fushës së tyre të ekspertizës. Individëve të përzgjedhur mund t'u kërkohet të udhëtojnë brenda dhe jashtë vendit si pjesë e detyrave të tyre apo edhe për qëllime trajnimiti.

Programi do të mbulojë për secilin individ të përzgjedhur shpenzimet e lidhura me pagën dhe përfitimet përkatëse, sipas kategorisë së pagave të institucionit ku vendosen. Individët e përzgjedhur nuk lejohet të jenë të punësuar diku tjetër gjatë vitit të angazhimit të tyre në institucionet shtetërore. Si shpërblim për privilegjin e pjesëmarrjes në Program, prej tyre pritet që të zbatojnë atë çfarë kanë mësuar duke kontribuar për kombin si udhëheqës në komunitetet e tyre, në profesionet e zgjedhura të karrierës dhe në sektorin publik. Nga personat e përzgjedhur mund të kthehen në angazhimet e tyre të mëparshme ose të ndërmarrin rrugë të reja në karrierën e tyre, duke qenë të pajisur me më shumë përvojë në fushat e politikave publike dhe vendimmarrje dhe më të përgatitur për të kontribuar për çështjet kombëtare, duke përmbushur kështu misionin e Programit.

IV. Përzgjedhja në Program

Për të aplikuar në programin "LEAD Albania", kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Aplikantët duhet të jenë nënshtetas shqiptarë (pranohet nënshtetësia e dyfishtë).
- Aplikantët duhet të kenë përfunduar studimet në arsimin e lartë. Përfundimi i studimeve pasuniversitare mund të jetë avantazh i rëndësishëm.
- Aplikantët duhet të kenë përvojë pune. Preferohet një minimum prej të paktën pesë vitesh. Në rast përfundimi të studimeve të doktoraturës, minimumi i preferuar zbritet në tre vjet.
- Personat të cilët punojnë aktualisht në aparatet e institucioneve që janë pjesë e institucioneve pritëse të Programit, nuk rekomandohen të aplikojnë. Personat të cilët punojnë aktualisht në institucionet e varësisë, institucionet vendore apo institucione të pavarura mund të aplikojnë, por jo për t'u angazhuar në të njëjtin institucion shtetëror.
- Nuk ka kufizime moshe. Megjithatë, Programi është krijuar për t'u dhënë aplikantëve të përzgjedhur përvojën e qeverisjes në fazat e para të karrierës së tyre.

V. Profili i kandidatëve

Programi "LEAD Albania" dhe Komisioni Përzgjedhës do të kenë parasysh kriteret e mëposhtme në përzgjedhjen e finalistëve:

- Arritje profesionale të rëndësishme në karrierë;
- Dëshmi të aftësive për lidërsip dhe potencial për rritje të mëtejshme;
- Interes i provuar për sferën publike dhe/ose shoqërinë civile;
- Aftësi për të pasur sukses në nivelet më të larta qeveritare dhe aftësi për të punuar efektivisht në ekip.

Cilësi të tjera të rëndësishme përfshijnë:

- Aftësi shumë të mira në të shkruar;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Qëndrim pozitiv;
- Aftësi të mira menaxhuese;
- Aftësi shumë të mira ndërpersonale;
- Nivel të mirë ekspertize në fushën e propozuar si fokus në kuadër të Programit.

VI. Komponenti i trajnimit

Elementi i dytë i Programit është komponenti i trajnimit. Do të ketë një sërë seminaresh në tema si politikat publike, vendimmarrje, politika e jashtme, politika të sigurisë, lidërsip, kompetenca sociale etj. Një fokus i madh i është dhënë zhvillimit të aftësive të lidërsipit. Duke qenë pjesë e Programit "LEAD Albania", pjesëmarrësit kanë mundësinë të marrin pjesë në trajnimin e posaçëm për zhvillimin e lidërsipit, i cili përgatitet dhe zhvillohet nga qendra "Center for Creative Leadership – CCL", e cila është e njohur në nivel botëror dhe e specializuar në këtë fushë. Gjithashtu, duke filluar nga Klasa 2018-2019, pjesëmarrësit marrin

pjesë në programe ekzekutive të zhvilluara në Harvard Kenedy School of Governance, mbi tema si negociimi, leadershipi, etj.

Nëpërmjet komponentit të trajnimit do të rriten mundësitë e pjesëmarrësve në Program për të njohur udhëheqës nga sektori publik dhe privat. Klasa e pjesëmarrësve në Program do të jetë pjesë e një serie takimesh dhe tryezash të rrumbullakëta me zyrtarë të lartë të nivelit qendror të qeverisjes, gazetarë, historianë, drejtues biznesi apo organizatash jo-qeveritare dhe drejtues të shteteve të huaja ose diplomatë. Programi i trajnimit do të variojë çdo vit sipas profilit të pjesëmarrësve të secilës klasë. Për aq sa është e mundur, takimet dhe seminarët do të organizohen pas orarit të punës, në mënyrë që të mos ndërpritet plani normal i punës i pjesëmarrësve në Program.

KALENDARI VJETOR I LEAD

KLASA AKTUALE

KLASA E RE

